

## SYLLABUS i Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Klinika Juridike Civile</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor (studime themelore)</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Semestri IV</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Prishtinë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>1. Prof. Asoc. Dr. Haxhi Gashi, 2. Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha,</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:haxhi.gashi@uni-pr.edu">haxhi.gashi@uni-pr.edu</a>; <a href="mailto:qerkin.berisha@uni-pr.edu">qerkin.berisha@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë lëndë mësohet për hartimin e shkesave të ndryshme në fushën civile duke filluar nga shkresat që i referohen statusit civil të personave fizik dhe juridike (fitimi i zotësisë juridike dhe të veprimit, marrja apo kufizimi i zotësisë së veprimit, çështjet statusore) dhe për të drejtat civile të karakterit pasuror siç janë. Kontratat (me të gjitha llojet), testamenti, premtimi publik, dokumentet për transaksione përmes të cilave palët i bartin ose kufizojnë të drejtat e karakterit pasuror.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët se si të kuptohen më mirë 1) Si duhet të hartohet një shkresë që i referohet të drejtave civile 2) cilat janë pasojat praktike të gabimeve në komunikim juridik me shkresat e tilla 3) raste studimi nga praktika dhe 4) zgjidhja e rasteve nga Gjykata.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Të jenë në gjendje për të marrë njohurit themelore se si hartohen shkresat që i referohen, krijimit, ndryshimit ose shuarjes të drejtave civile të karakterit personal dhe pasuror;</li><li>2. Aspekt të ndryshme lidhur me formatin e shkresave;</li><li>3. Njohuri për përmbajtjen e një shkrese.</li><li>4. Realizimin e të drejtave të parapara me ligj për</li></ol>

	<p>të cilat kërkohet hartimi i shkresave</p> <p>5. Marrje e njohurive nga rastet praktike dhe simulimet në Klasë.</p> <p>6. Pasojat ligjor dhe zgjidhja e rasteve nga gjykatat në fushën e të drejtës civile</p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	1	1/15	15
Kollokfiume,seminare	2	2/5	10
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	1/1	5
Projektet,prezentimet ,etj	10	1/1	10
<b>Totali</b>	<b>5 ECTS</b>	<b>Total</b>	<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve</p> <p><i>Ligjëratat:</i> mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive –bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike dhe instruksione për student për çështjent nga programi mësimorë.</p> <p><i>Raste studimi-simulimi:</i> gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen në si detyrë shtëpie dhe të sjellën te profesori në kohën e kërkuar. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i shkresave në klasë ose detyrë shtëpie. Simulimi i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në çështje krahasuese të drejtës civile.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	- Pjesëmarrja e studentëve 20%		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Rasti i studimit</i> 30% (15% rastet e studimit në klasë dhe 15% rastet e studimit detyrë shtëpie)</li> <li>- <i>Provimi përfundimtar</i> 50% (provimi përfundimtar organizohet në formë me shkrim i cili përbëhet nga 50% e pikëve pyetje alternative dhe të hapura, 25% ese dhe 25% rast i shkurtër studimi. Kalueshmëria me 60% e pikëve të fituara).</li> </ul> <p><b><u>Ndërtimi i notës:</u></b></p> <table border="0"> <tr> <td>• <b>%</b></td> <td>• <b>Nota</b></td> </tr> <tr> <td>• 91-100</td> <td>• 10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>• 81-90</td> <td>• 9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>• 71-80</td> <td>• 8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>• 61-70</td> <td>• 7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>• 51-60</td> <td>• 6 (gjashtë)</td> </tr> </table>	• <b>%</b>	• <b>Nota</b>	• 91-100	• 10 (dhjetë)	• 81-90	• 9 (nëntë)	• 71-80	• 8 (tetë)	• 61-70	• 7 (shtatë)	• 51-60	• 6 (gjashtë)
• <b>%</b>	• <b>Nota</b>												
• 91-100	• 10 (dhjetë)												
• 81-90	• 9 (nëntë)												
• 71-80	• 8 (tetë)												
• 61-70	• 7 (shtatë)												
• 51-60	• 6 (gjashtë)												
<b>Literatura</b>													
<b>Literatura bazë:</b>	<p><b>Literatura:</b> (Literatura si më poshtë do të përdoret në ato pjesë ku shtjellohen temat e parapara. Gjatë ligjëratave jepen instruksione se cilat faqe duhet lexuar dhe përpunuar)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Abdulla Aliu, E drejta civile, pjesa e përgjishme, Prishtinë 2013</li> <li>- Haxhi Gashi, Material mësimor për studentë: Klinika Juridike Civile, (Handout), Prishtinë 2013</li> <li>- Nerxhivane Dauti, E drejta kontraktues, Praktikum, Prishtinë, 2011</li> <li>- Haxhi Gashi, Abdulla Aliu, Adem Vokshi, Komentari i Ligjit të Familjes, Publikuar nga GIZ, Prishtinë 2012</li> <li>- Iset Morina, Selim Nikqi, Komentari i Ligjit për Proceduren Kontestimore, Publikuar nga GIZ, 2012.</li> </ul>												
<b>Literatura shtesë:</b>	<p><b>Ligjet relevante:</b> (Ligjet janë të obligueshme gjatë ligjëratave, sepse do të ketë referime të çështjeve në nenet e caktuar të ligjeve. Gjithashtu rastet do të përpunohen duke ju referuar neneve të ligjeve). Ligjet mund të merren në linkun e Gazetes Zyrtare të Republikës së Kosovës si në vijim: <a href="http://gazetazyrtare.rks-gov.net/">http://gazetazyrtare.rks-gov.net/</a></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligji i Familjes i Kosovës, 2006</li> <li>2. Ligji i Trashëgimit i Kosovës, 2005</li> <li>3. Ligji për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, 2009</li> <li>4. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, 2012</li> <li>5. Ligji për procedurën kontestimore, 2008</li> <li>6. Ligji për procedurën jokontestimore, 2009</li> <li>7. Ligji për procedurën përmbaruese, 2012</li> <li>8. Ligji për gjykatat 2012.</li> </ol>												
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>													
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>												
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Objekti dhe qëllimi i lëndës</li> <li>- Studim i një rasti praktik lidhur me të drejtat statusore</li> </ul>												

<i>Java e dytë:</i>	- Fitimi i të drejtave statusore për personat fizik - Rast studimi/hartim i një dokumenti statusor
<i>Java e tretë:</i>	- Humbja e të drejtave statusore për personat fizik - Rast studimi/hartim të një dokumenti statusor
<i>Java e katërt:</i>	- Fitimi i të drejtave statusore për personat juridike - Rast studimi/hartimi i një dokumenti statusor (hartimi i një statuti për shoqëritë aksionare)
<i>Java e pestë:</i>	- Humbja e të drejtave statusore për personat juridik - Rast studimi/hartimi i një dokumenti statusor
<i>Java e gjashtë:</i>	- Fitimi i një të drejte pasurore për personat fizik - Rast studimi/hartim i një dokumenti për fitimin e pronësisë
<i>Java e shtatë:</i>	- Ndryshimi apo kufizimi i një të drejte pasurore për personat fizik - Rast studimi/hartimi i një dokumenti për kufizimin e pronësisë
<i>Java e tetë:</i>	- Bartja e një të drejte pasurore nga personat fizik ose juridik - Rast studimi/ Hartimi i një dokumenti (kontrate për bartje të pronësisë)
<i>Java e nëntë:</i>	- Bartja e një të drejte në mënyrë të njëanshme - Rast studimi/hartimi i një dokumenti me shprehje të një anshme të vullnetit (Testament)
<i>Java e dhjetë:</i>	- Veprimet juridike në favor të njëres palë - Rast studimi/hartimi i një kontrate të dhuratës
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	- Rast studimi - Shqyrtim i kontestit në mes palëve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	- Rast studimi - Shqyrtim i kontestit në mes palëve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	- Rast simulues
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	- përmbledhje, diskutime dhe evaluimi i kursit
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	- Testi final

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- a) Gjatë vijimit të kursit duhet të ruhet integriteti personal dhe akademik i mësimdhënësit dhe studentit
- b) Pjesëmarrja e studentëve është e detyrueshme (çdo mungesë e paarsyeshme reflektohet në vlerësimin përfundimtar)
- c) Studentët duhet ti përmbushin detyrimet e dhëna gjatë punës praktike dhe detyrimeve të shtëpisë. Mungesa e përmbushjes së detyrimeve reflektohet në kalueshmërinë e provimit.
- d) Studentët duhet ti përmbahen rregullave disiplinore të mbarëvajtjes së ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit.
- e) Plagjiatura dhe format e ndryshme të kopjimit janë të ndaluara dhe reflektohen në vlerësimin negativ për studentin dhe ndëshkime tjera sipas rregullave përkatëse ligjore.